



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:072860

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429788

C.nr.512/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.Ç nga Vushtria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. K.B nga Vushtria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i shujtave, jashtë seance me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.Ç nga Vushtria dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër te kompensimit të ushqimit (shujtave ditore) nga dy euro për ditë pune për periudhën nga data 01.12.2019 e deri me datë 21.11.2022 (461 ditë pune), t’ia paguaj paditëses shumën prej 922.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë (16.04.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja M.Ç nga Vushtria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. K.B nga Vushtria, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 16.04.2021, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që t’ia kompensojë në emër të ushqimit- shujtave për 208 ditë pune shumën prej 2 euro në ditë, në total shumën prej 416.00 euro. Ndërsa, me parashtrësën e datës 10.01.2023 ka bërë precizimin dhe zgjerimin e padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar që e paditura t’ia kompensojë në emër të shujtave nga data 01.12.2019 e deri më 09.12.2022 për 461 ditë pune, shumën prej 922.00 euro, si dhe ka kërkuar kompensimin në emër të licencimit dhe inflacionit (për inflacion

me parashtrësën e datës 15.11.2023), me kamatë ligjore prej 8%, nga paraqitja e padisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë arritur Marrëveshjen e Ndërmjetësimit me numër Nd.nr.864/23 të datës 16.11.2023, të cilën gjykata e ka aprovuar me Aktvendimin e datës 16.11.2023, si dhe Aneks marrëveshjen e Ndërmjetësimit të datës 21.11.2023, të cilën gjykata e ka aprovuar me Aktvendimin e datës 20.11.2023. Në marrëveshjen e arritur palët janë dakorduar që e paditura t'ia kompensojë paditëses në emër të kualifikimit- licencimit si dhe në emër të inflacionit, shumat e përcaktuara më gjerësisht si në marrëveshje. Andaj, pjesë e kërkesëpadisë ka mbetur vetëm kompensimi i shujtave për ditët e pranisë në punë. Po ashtu, të autorizuarit e palëve janë pajtuar edhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës, të specifikuara si në marrëveshjen e lartcekur

Gjykata me aktvendimin C.nr.512/21 të datës 19.09.2023, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 20.09.2023, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 25.09.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija e paditëses është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 11.03.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditëset kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe me kontratën numër 81/17 të datës 23.09.2015. Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shujtave-ushqimit në punë.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Këtë gjykata e vërtetoi edhe nga provat e ofruara nga paditësja dhe atë vërtetimi i lëshuar nga SH.F “M.”, në Vushtrri, i datës 06.03.2024, me anë të të cilit vërtetohet se paditësja ka punuar në këtë shkollë për periudhën nga data 01.12.2019 e deri më 21.11.2022, andaj ia njohu shumën prej 922.00 euro, për 461 ditë pune, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro (461 x 2 = 922.00).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar për periudhën nga data 01.12.2019 e deri më 21.11.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 si dhe ajo e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 16.04.2021.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 16.04.2021, dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par. 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën, me nr. 265/2020 i datës 01.12.2020.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, edhe pse paditësja në padi i ka kërkuar, siç u theksua edhe më lartë, palët janë dakorduar për shpenzimet në procedurë të ndërmjetësimit, andaj nuk ishin objekt i shqyrtimit të gjykatës, ndërsa sa i përket shpenzimeve të kërkuara për plotësimin-precizimin e padisë në shumë prej 104 euro, gjykata nuk ia njohu paditëses këtë shpenzim, sepse ky precizim i padisë është bërë pas aktvendimit C.nr.512/21, të datës 01.03.2024, me të cilin gjykata e ka ftuar paditësen për plotësimin e padisë me provën-vërtetimin për ditët e pranisë në punë të lëshuar nga e paditura, pra ky shpenzim është krijuar me fajin e paditëses, andaj edhe nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat janë krijuar me fajin e vet paditëses.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.512/2021, me datë 08.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.